

Vendim nr. 85 datë 26.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 26.04.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 16 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AFRIM KALLARI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 5 datë 31.01.2017 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 34 datë 25.04.2017 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; nr. 00-2012-1819, datë 03.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Afrim Kallari në vitin 2017 është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për kryerjen e veprave penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” dhe “Dhunë në familje”, të parashikuara nga nenet 79/c, dhe 130/a/3 të Kodit Penal (*KP*). Në datën 03.06.2016 ai ka vrarë me armë gjahu vëllain e tij, shtetasin

E.K., si dhe ka plagosur nënën e tij, shtetasen B.K. Kërkuesi dhe vëllai i tij punonin si roje në vendin e quajtur “Stalla” në fshatin Valias, Kamëz të qytetit të Tiranës. Shkak për ngjarjen është bërë konflikti midis dy vëllezërve në lidhje me ndalimin nga kërkuesi për të hyrë në vendin ku ai punonte gjatë turnit të tij, vajza e viktimës dhe nëna e tij për të kullotur lopë. Menjëherë pas ngjarjes kërkuesi është vetëdorëzuar në organet e policisë dhe njëkohësisht është kryer arrestimi i tij në kushtet e flagrancës.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. 5, datë 31.01.2017, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Afrim Kallari për kryerjen e veprës penale “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm; Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i KP-së dhe dënimin e tij me 4 vite burgim; Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin e tij me burgim të përjetshëm; Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dënimin përfundimtar me 35 vjet burgim.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

3. Me vendimin nr. 34, datë 25.04.2017, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 5 datë 31.01.2017 të Gjykatës për Krime të Rënda, lidhur me fajësinë, cilësimin juridik dhe masën e dënimit për veprën penale “Dhuna në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/3 i KP-së; Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm lidhur me fajësinë, cilësimin juridik për veprën penale “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c i KP-së, duke ndryshuar masën e dënimit për këtë veprë si vijon; Në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin e të pandehurit me dënim të vetëm 35 vjet burgim; Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së, uljen me 1/3 e dënimit të më sipërm me një masë dënimi prej 23 vjet e 4 muaj burgim; Lënien në fuqi të vendimit në pjesët e tjera të tij.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1819, datë 03.11.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit”, të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda.*

5. Në datën 02.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimeve nr. 5, datë 31.01.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nr. 34, datë 25.04.2017 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe nr. 00-2012-1819, datë 03.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkesit

6. **Kërkuesi** ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nuk duhej ta kishte pranuar kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar dhe duhet t'ia nënshtrohte atë marrjes së provave në seancë, por edhe për faktin se në cilësinë e personit nën hetim, ai ka ngritur probleme dhe qëndrime ligjore që kishin nevojë të verifikoheshin në seancë gjyqësore, siç është kontradikta me provat materiale të marra në vendngjarje. Në këto kushte, ky proces është i pavlefshëm dhe antikushtetues, pasi gjykimi i shkurtuar është një përfitim që nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Kur çmojnë se janë prekur interesat e një mbrojtjeje efektive, si një nga standardet kushtetuese, gjykatat kanë si detyrë ta rrëzojnë këtë kërkesë. Ato duhet të udhëhiqen jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore, por kryesisht duhet të veprojnë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Duke e pranuar kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, gjykata i ka cenuar atij të drejtën e mbrojtjes efektive.
- 6.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata nuk ka dhënë shpjegime për mospranimin e qëndrimeve të kërkesit, nuk ka arsyetuar në lidhje me parashtrimet e tij dhe të mbrojtjes gjatë procesit gjyqësor për qëndrimet e tij dhe të nënës së viktimës, të cilat janë kontradiktore. Gjykata duhet t'u japë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në proces.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes

së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Në rastin konkret, kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara, duke provuar interesin e tij në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

11. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr.17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018; nr.31, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuuesi kundërshton të tria vendimet e gjykatave të zakonshme, ndërsa në thelb pretendimet e tij kanë të bëjnë me vendimet e gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit, për sa i përket masës së dënimit. Procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin nr. 00-2012-1819, datë 03.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të ushtruar nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, ndërkohë që vetë kërkuuesi nuk rezulton të ketë ushtruar as rekurs dhe as kundërrkurs, pas vënies në dijeni të rekursit të prokurorit.

13. Në kushtet kur kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pa ushtruar më parë rekurs, Kolegji vlerëson se ai nuk ka shteruar mjetet ligjore efektive në

dispozicion të tij përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa e paraqitur nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.